



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu



-III-

Nr. I prot

Br. prot.

1103

Më

Dt.

02-04-2024

RAHOVEC - ORAHOVAC



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLICA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E RAHOVECIT/ OPŠTINA ORAHOVAC/ MUNICIPALITY OF RAHOVEC

Njësia e Auditimit të Brendshëm
Komuna e Rahovecit

RAPORT TREMUJOR I PUNËS

Për periudhën 01.01.2024 - 31.03.2024

02.04.2024

Raporti i punës së NJAB-së për periudhën Janar-Mars të vitit 2024

Në periudhën Janar – Mars, Njësia e Auditimit të Brendshëm për punën e vet, është bazuar kryesisht në Planin vjetor të punës për vitin 2024, i cili plan është i aprovuar nga Kryetari i Komunës së Rahovecit.

Ndërsa bazë ligjore ka pasur Ligjin Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, Udhëzimet Administrative për Auditim të Brendshëm, Doracakun e Auditimit të Brendshëm, Statutin e Auditimit të Brendshëm dhe Instruksionet lidhur me Standardet Ndërkombëtarë të Auditimit të Brendshëm.

Sipas Planit Vjetor të NJAB-së, për periudhën Janar – Mars të vitit 2024, kemi arritur të kryejm 1 (një) auditim, sipas planit vjetor të punës.

Në listën e mëposhtme do të paraqiten të gjitha auditimet të planifikuara dhe të kryera për periudhën Janar - Mars të vitit 2024 sipas Planit Vjetor.

Drejtoritë e audituara të Planifikuara dhe të realizuara për periudhën Janar – Mars të vitit 2024


1. Auditimi i Brendshëm në Zyrën e Prokurimit..

Aktivitetet dhe angazhimet e tjera të Njesisë së Auditimit të Brendshëm

Angazhimet tona kryesisht kanë qenë:

- Vlerësimi i objektivave për auditime, sipas shkallës së rrezikshmërisë, është pregaditur Plani Strategjik i NJAB për vitet 2024 – 2026, dhe Plani Vjetor i Punës së NJAB-së për vitin 2024.
- Është pregaditur raporti i gjashtëmujorit të dytë dhe raporti vjetor i NJAB-së për vitin 2023, i janë dorëzuar Njesisë Qendrore për Harmonizim të Auditimit të Brendshëm (NjQHAB), Kryetarit të Komunës dhe Komitetit për Auditim të Brendshëm, të gjitha janë dorëzuar brenda afatit kohor të paraparë me ligj.
- Verifikimi i zbatueshmërisë së rekomandimeve të dhëna në periudhën Janar – Dhjetor të vitit 2023.
- Gjithashtu NjAB-ja ka pasur angazhime me të gjithë zyrtarët të cilët me një formë ose tjetër kanë qenë të kyçur në procesin e implementimit të rekomandimeve.

Udhëheqësi i NjAB-së



Ruzhdi Kabashi